



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" "UKSHIN HOTI"
Prizren

Pranuar rre dt. 26.07.2023	
Zyra e pranimit 308	Nr. i protokollit 03-320

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë, Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01- _____

Prizren, me: ___/___/_____

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe vendimin e Këshillit Drejtues nr. 01-465, Universiteti „Ukshin Hoti“ në Prizren shpall:

KONKURS
PËR PUNË PRAKTIKE ME PAGESË PËR TË DIPLOMUARIT NË
UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI"

Ftohen studentët e diplomuar në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit në pozitën si më poshtë:

- Dy praktikantë në Zyrën e Teknologjisë së Informacionit;

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e diplomuar në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin "Ukshin Hoti", data e diplomimit e të cilëve është para datës së publikimit të këtij konkursi.

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

Vlerësimi i studentëve për këtë pozitë bëhet sipas sistemit të pikëve. Numri maksimal i pikëve është 100. Deri në 40 % të pikëve kandidati i mbledh nga nota mesatare, 30% nga vlerësimi i CV dhe letrës motivuese si dhe deri në 30% nga intervista me gojë. Kohëzgjatja e punës praktike është tre muaj.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Letrën motivuese dhe CV-në.
2. Kopjen e diplomës
3. Kopjen e letërnjoftimit
4. Certifikatën penale

- Aplikimi është i hapur deri më datën 01.08.2023 në ora 16:00.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni Ad Hoc i formuar nga ZKA do të bëhet me datën 02.08.2023
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin e cila përgatitet nga NJMBNJ dhe nënshkruhet nga ZKA.
- Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën: rektorati@uni-prizren.com.
- Praktikantët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores nr. 01-638 (08:00-16:00)

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të Universitetit.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e Universitetit pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike do të pajisen nga Universiteti "Ukshin Hoti" me: Referencë dhe Certifikatë.